



# Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo


## AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT

### AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE

#### ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCY PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPK  
 Nr. Prot. 03-03/370/21  
 Dato: 19.02.2021  
 Nr. pages 03



DATË/A:	18.02.2021
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-317/21
PËR/ZA/TO:	z. Nazim BERBATOVCI, Menaxher i Prokurimi, N.P.L. "Pallati i Rinisë" SH.A.
CC:	z. Ilir DUGOLLI, U.D. Kryeshef Ekzekutiv N.P.L. "Pallati i Rinisë" SH.A.
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
NGA/OD/FROM:	Afrim ATASHI, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " <b>Rregullimi i kulimit të dëmtuar nga erërat dhe nga qarjet</b> "



#### *I nderuar z. Berbatovci,*

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nenit 2 par.3 dhe të nenit 10 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores nr. 01/2017, së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: "**Rregullimi i kulimit të dëmtuar nga erërat dhe nga qarjet**" me numër të prokurimit: PR 2019/21/500/521, dhe me nr. të brendshëm: Pr2019/21/006/521, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

### OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin: "**Rregullimi i kulimit të dëmtuar nga erërat dhe nga qarjet**" me numër të prokurimit: PR 2019/21/500/521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr.04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

## *Arsyetimi*

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 16 shkurt 2021, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-317/2021*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull: **"Rregullimi i kulimit të dëmtuar nga erërat dhe nga qarjet"** me numër të prokurimit: PR 2019/21/500/521, i iniciuar nga autoriteti kontraktues N.P.L. "Pallati i Rinisë" SH.A.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi Elektronik i Prokurimit ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë publike, të llojit punë, me vlerë të mesme të parashikuar prej 40,000.00 €.

Në kuadër të rubrikës III.2.4. Kapaciteti teknike dhe profesionale kërkesa 1, Agjencia vëren se, Autoriteti kontraktues *ka kërkuar nga operatorët ekonomik pjesëmarrës të ofrojnë dëshmi se kanë përfunduar me sukses minimum 2 (dy) kontrata të ngjashme-rregullim të kulmeve në vlerë financiare minimumi 60,000.00€, në periudhën e shkuar në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të njoftim për kontratë kërkesë kjo për të cilën konsiderojmë se bie ndesh me nenin 69 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik.*

Sipas Legjislacionit në fuqi për Prokurim Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 6.2. parashihet se "Për të vërtetuar aftësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, autoriteti kontraktues mundet të kërkojë listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore; certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; sa herë që është e mundur, autoriteti kontraktues mund të obligohet që të dakordohet me autoritetin publik kompetent në Kosovë ose në vendin tjetër që kopjet e certifikatave përkatëse t'ia paraqes drejtpërdrejtë autoritetit kontraktues".

Agjencia konsideron se autoriteti kontraktues nuk ka të drejtë të bëjë kufizimin e numrit të kontratave në vlerën e caktuar. E rëndësishme për autoritetin kontraktues është që ta vërtetoj se operatorët ekonomik përmbushin vlerën minimale e cila është kërkuar nga ana e autoritetit kontraktues pavarësisht numrit të kontratave. E jo si në rastin konkret ku është kërkuar numri i kontratave në vlerë të caktuar.



Konsiderojmë se kërkesat e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë operatorët ekonomik të cilët kanë një kapacitet të kënaqshëm ekonomik, teknik-profesional.

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim dhe Jo-diskriminim, si dhe nenin 69 Aftësitë Teknike dhe Profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

*Me respekt !*